



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 5193 Prot.

Tiranë, më 29.9. 2020

URDHËR

NR. 293, DATË 29.9. 2020

PËR  
CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2020-2021 NË  
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 1 të nenit 87 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2020 - 2021 në institucionet e arsimit të lartë fillon më datë 2 nëntor 2020.
2. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit të kandidatëve fitues, të dërgojnë në të gjitha ndërmarrjet “Trajtimi i Studentëve” sh.a., listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Evis KUSHI

